



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORT RREGULLATIV
Përcaktimi i Tarifave për Ngrohtoren e Qytetit TERMOKOS SH.A.
Sezoni i Ngrohjes 2025-2026

Prishtinë, dhjetor 2025



1. Hyrje – Struktura Tarifore

Struktura tarifore për energjinë termike është përcaktuar në përputhje me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike të nxjerrë nga ZRRE (Kapitulli IV: Tarifatat e energjisë termike – nenet 15 dhe 16). Struktura e tarifave të energjisë termike përmban 2 lloje të tarifave: Tarifatat për 'konsumatorët me matje' dhe tarifatat për 'konsumatorët pa matje', varësisht nga Infrastruktura e matësve (njehsorëve) të energjisë termike.

1.1 Tarifatat për 'konsumatorët me matje'

Tarifatat për 'konsumatorët me matje' janë të bazuara në konsumin e matur dhe të regjistruar të energjisë termike. 'Tarifat me matje' përbëhen nga:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes [€/kW për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo €cent/kWh];

1.2 Tarifatat për 'konsumatorët pa-matje'

Tarifatat për 'konsumatorët pa-matje' bazohen në sipërfaqen e hapësirës së ngrohur të konsumatorëve. Duke marrë parasysh se vlerat e parallogaritura për kapacitetin dhe konsumin specifik të energjisë termike për metër katrorë janë të ndryshme për Konsumatorët Shtëpiak dhe ata Komercial e Institucional, për këtë, me qëllim që tarifatat të reflektojnë strukturën specifike të konsumit për secilën kategori, 'tarifat pa-matje' ndahen në dy nën-grupe:

- Tarifatat për konsumatorët shtëpiak; dhe
- Tarifatat për konsumatorët komercial e Institucional.

Më tutje, 'tarifat pa-matje' kategorizohen në dy komponentë:

- Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa mujore e kapacitetit bazuar në një vlerë të përafërt për kapacitet të ngrohjes për metër katror të hapësirës për ngrohje [€/m² për muaj]; dhe
- Komponenti variabil i tarifës: pagesa mujore e energjisë bazuar në një vlerë të përafërt për konsum të ngrohjes për metër katror të sipërfaqes ngrohëse [€/m² për muaj].

2. Alokimi i të Hyrave të Lejuara dhe Përcaktuesit e Faturimit

Duke ju referuar Shtojcës 6: "Detajet për Llogaritjen e Tarifave" të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe për të reflektuar strukturën tarifore, për llogaritjen e tarifave të energjisë termike duhet të përcaktohet alokimi i të Hyrave të Lejuara dhe Përcaktuesit e Faturimit.

Elaborim i alokimit të të hyrave dhe përcaktuesve të faturimit në ndërlidhje me projektin MCC – 'Prishtina Heat Save' për matjen e konsumit në nivel apartamenti në ndërtesat kolektive

Llogaritja e koeficienteve të alokimit të të hyrave të lejuara dhe përcaktuesve të faturimit me matje bazohet në konsumin e parashikuar të grupeve të konsumatorëve. Në mungesë të matjes së plotë në nivel nënstacioni, parashikimi i konsumit është bërë duke u bazuar në matjet ekzistuese në nënstacionet termike, sipërfaqet ngrohëse të konsumatorëve dhe parametrat përafërt si konsumi / kapaciteti specifik për metër katror të sipërfaqes ngrohëse dhe orët e ngarkesës së plotë.



Në sezonin e kaluar 2024/25, një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve janë faturuar me matje, edhe pse kanë qenë të pranishme mjaft probleme dhe devijime në të dhëna. ZRRE ka kërkuar dokumente shtesë dhe analiza të zhvillimeve lidhur me projektin, dhe NQ Termokos ka dorëzuar disa analiza dhe përmirësime për disa nënstacione të caktuara, kryesisht ku devijimet kanë qenë më të larta. Megjithatë, analizat e dorëzuara ende nuk ofrojnë një pasqyrë të plotë dhe lënë shumë për të dëshiruar, duke krijuar nevojën për rishikim dhe monitorim të vazhdueshëm.

Për këtë sezon, ZRRE ka vazhduar të bëjë përshtatjet e nevojshme të alokimeve dhe përcaktuesve të faturimit duke u bazuar në trendet e sezonit të kaluar dhe të dhënat e disponueshme, me qëllim të minimizimit të devijimeve dhe sigurimit të faturimit sa më korrekt për konsumatorët rezident të ndërtesave kolektive.

Në pasqyrat rregullative me planifikimet për shqyrtimin tarifor të sezonit 2025/2026, NQ Termokos ka dorëzuar sipërfaqet ngrohëse si në vijim:

- Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve me matje: **1,600,022 m²**;
- Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve pa matje: **756,422 m²** e ndarë në grupe të konsumatorëve:
 - Konsumatorët shtëpiak (amvisëri): **613,676 m²** – pjesëmarrja: 81% (0.81); dhe
 - Konsumatorët komercial e institucional: **142,746 m²** – pjesëmarrja: 19% (0.19).
- Total sipërfaqja ngrohëse: **2,356,444 m²**

Në vijim të kërkesave të përsëritura nga ZRRE, NQ Termokos më datë 05.09.2025 ka dorëzuar në formë tabelare disa të dhëna, përkatësisht Raportin e instalimeve të realizuara për njësitë ngrohëse për sezonin ngrohës 2024/25 dhe Raportin e instalimeve të realizuara për njësitë ngrohëse për periudhën janar–gusht 2025, në mënyrë specifike për disa nënstacione. Këto raporte janë përgatitur nga projekti.

ZRRE ka kërkuar gjithashtu dokumentacion shtesë lidhur me sipërfaqet ngrohëse, me ç'rast në disa nënstacione janë bërë korrigjime të sipërfaqeve përkatëse. Megjithatë, duhet theksuar se këto të dhëna nuk janë të plota, pasi mbetet e nevojshme që të rishikohen dhe monitorohen sipërfaqet ngrohëse edhe për nënstacionet e tjera.

Ndërmarrja do të vazhdojë edhe gjatë sezonit me korrigjimin e sipërfaqeve ngrohëse, përmirësimin e bazës së të dhënave dhe vazhdimin e ekzekutimit të projektit, me qëllim të eliminimit të problemeve. ZRRE, nga ana e saj, do të jetë në monitorim të vazhdueshëm përmes raporteve periodike ditore dhe mujore mbi zhvillimet, veçanërisht gjatë sezonit ngrohës.

2.1 Alokimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara (HML)

Alokimi i të Hyrave të lejuara bëhet konform strukturës tarifore, të përshkruar në pikën '1' më lartë, me pikë fillestare të Hyrat e Lejuara, siç janë përcaktuar në Raportin për të Hyrat e Lejuara për NQ Termokos për sezonin e ngrohjes 2025/26, në vlerë prej **11,463,803 €**. Kriter themelorë për alokimin është konsumi i përlllogaritur i energjisë termike për secilën kategori/komponentë tarifore. Bazuar në këtë kriter dhe kategoritë / komponentët e strukturës tarifore, janë përcaktuar koeficientët e alokimit dhe alokimi respektiv i të Hyrave të Lejuara; detajet në vijim:

- Alokimi i HML për tarifat e 'Konsumatorëve me-matje' dhe 'pa-matje' - Alokimi përkatës i të Hyrave të Lejuara bëhet përmes koeficientëve respektiv të alokimit, si në vijim:



a) Për tarifën 'me-matje': $k_{al(matje)} = 0.69$; $HML_{(matje)} = 7,834,912 \text{ €}$

b) Për tarifën 'pa-matje': $k_{al(pamatje)} = 0.31$; $HML_{(pamatje)} = 3,628,891 \text{ €}$

- Alokimi i HML në komponentën Fikse dhe Variabile:

a) Për tarifën 'me-matje':

i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara: $HML_{F(matje)} = 846,171 \text{ €}$; dhe

ii) Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara: $HML_{V(matje)} = 6,988,742 \text{ €}$

b) Për tarifën 'pa-matje':

i) Pjesa fikse e të Hyrave të Lejuara: $HML_{F(pamatje)} = 526,189 \text{ €}$;

e cila më tutje ndahet në:

▪ kategorinë shtëpiak: $HML_{F(pamatje-Sh)} = 408,017 \text{ €}$ dhe

▪ kategorinë komercial e institucional: $HML_{F(pamatje-K\&I)} = 118,172 \text{ €}$

ii) Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara: $HML_{V(pamatje)} = 3,102,701 \text{ €}$

e cila më tutje ndahet në:

▪ kategorinë shtëpiak: $HML_{V(pamatje-Sh)} = 2,405,894 \text{ €}$ dhe

▪ kategorinë komercial e institucional: $HML_{V(pamatje-K\&I)} = 696,808 \text{ €}$

2.2 Përcaktuesit e Faturimit

Njëjtë si alokimi i të Hyrave të Lejuara, edhe përcaktuesit e faturimit reflektojnë dhe janë në pajtim me strukturën tarifore; detajet në vijim:

a) Për tarifën 'me-matje':

i) Kapaciteti termik: $N_{matje} = 192,003 \text{ kW}$; dhe

ii) Konsumi sezonal: $Q_{matje} = 207,665 \text{ MWh}$.

b) Për tarifën 'pa-matje':

i) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve shtëpiak: dhe $S_{(pamatje-Sh)} = 613,676 \text{ m}^2$;

ii) Sipërfaqja ngrohëse e konsumatorëve komercial e Institucional: $S_{(pamatje-K\&I)} = 142,746 \text{ m}^2$

3. Nivelet e Tarifave të Energjisë Termike

Në pajtim me strukturën tarifore, si dhe bazuar në alokimin e të Hyrave të Lejuara dhe përcaktuesit e faturimit, llogariten nivelet e tarifave për secilën kategori / komponentë tarifore, siç paraqiten në tabelën vijuese:



Tabela 1: Struktura dhe nivelet e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos për sezonin 2025/26:

Llogaritja e Tarifave të Energjisë Termike -sezonin 2025-2026

A. Tarifat e Energjisë Termike me Matje				
Simboli/Poz.	Përshkrimi	Formula	Njësia	Vlera
$MAR_{(matje)}$	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për tarifat me matje	$MAR_{(matje)} = k_{al(matje)} * MAR$	Euro	7,834,912
$MAR_{F(matje)}$	Pjesa fikse e MAR për tarifat me matje	$MAR_{F(matje)} = k_{al(FIX)} * MAR_{(matje)}$	Euro	846,171
$MAR_{V(matje)}$	Pjesa Variabile e MAR për tarifat me matje	$MAR_{V(matje)} = k_{al(VAR)} * MAR_{(matje)}$	Euro	6,988,742
N_{matje}	Kapaciteti Termik	$N_{matje} = (S_{matje} * CDsp.) / 1000$	kW	192,003
Q_{matje}	Konsumi / Furnizimi i planifikuar sezonal	$Q_{matje} = HD_{matje} * t_{efic.}$	MWh	207,665
T_{YHC}	Tarifa Sezonal për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{YHC} = MAR_{F(matje)} / N_{matje}$	€/ kW për sezonë	4.41
T_{mHC}	Tarifa mujore për kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{mHC} = T_{YHC} / 6$	€/ kW për muaj	0.73
T_{HD}	Tarifa për Sasinë e Furnizuar të Energjisë Termike (Komp. Variab.)	$T_{HD} = MAR_{V(matje)} / Q_{matje}$	€/ MWh	33.65

B. Tarifat e Energjisë Termike Pa Matje						
Simboli/Poz.	Përshkrimi	Formula	Njësia	Vlera		
				Gr. Kons. Shtëpijak	Gr. Kons. Kom. e Inst.	Total / Mesatare
$MAR_{(pamatje)}$	Të Hyrat Maksimale të Lejuara për tarifat pa matje	$MAR_{(pamatje)} = k_{al(pamatje)} * MAR$	Euro	2,813,911	814,980	3,628,891
$MAR_{F(pamatje)}$	Pjesa fikse e MAR për tarifat pa matje	$MAR_{F(pamatje)} = k_{al(FIX)} * MAR_{(pamatje)}$	Euro	408,017	118,172	526,189
$MAR_{V(pamatje)}$	Pjesa variabile e MAR për tarifat pa matje	$MAR_{V(pamatje)} = k_{al(VAR)} * MAR_{(pamatje)}$	Euro	2,405,894	696,808	3,102,701
$S_{(pamatje)}$	Sipërfaqja ngrohëse e Kons. pa matje		m ²	613,676	142,746	756,422
T_{YHC}	Tarifa Sezonal për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{YHC} = MAR_{F(pamatje)} / S_{(pamatje)}$	€/m ² për sezonë	0.66	0.83	0.70
T_{YHD}	Tarifa Sezonal për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Variab.)	$T_{YHD} = MAR_{V(pamatje)} / S_{(pamatje)}$	€/m ² për sezonë	3.92	4.88	4.10
T_{mHC}	Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. Fikse)	$T_{mHC} = T_{YHC} / 6$	€/m ² për muaj	0.11	0.14	0.12
T_{mHD}	Tarifa Mujore për Sasinë e furnizuar të En. Term. (Komp. Variab.)	$T_{mHD} = T_{YHD} / 6$	€/m ² për muaj	0.65	0.81	0.68
T_{total}	Totali i tarifës mujore pa matje	$T_{total} = T_{mHC} + T_{mHD}$	€/m ² për muaj	0.76	0.95	0.80